



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 559 prot.  
18

Tiranë, më 09.11.2022

VENDIM

Nr. 920 Datë 09.11.2022

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE TË SHËRBIMIT IT TË KONTRON AG NGA SHOQËRIA VINCI ENERGIES S.A”.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|      |                 |            |
|------|-----------------|------------|
| Z.   | Denar BIBA      | Kryetar    |
| Znj. | Leida MATJA     | Zv/Kryetar |
| Znj. | Adriana BERBERI | Anëtar     |
| Znj. | Rezana KONOMI   | Anëtar     |
| Z.   | Durim KRAJA     | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 09.11.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive të shërbimit IT të Kontron AG nga shoqëria Vinci Energies S.A.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive të shërbimit IT të Kontron AG nga shoqëria Vinci Energies S.A.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive të shërbimit IT të Kontron AG nga shoqëria Vinci Energies S.A.

Referuar “Marrëveshjes për blerjen e aksioneve për shit-blerjen e shoqërive të Kontron IT Service”, datë 10.08.2022, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse: Vinci Energies S.A.**, është një shoqëri anonime, e krijuar sipas legjislacionit të Francës, me veprimtari kryesore; instalime elektrike. Vinci Energies S.A. është filial i zotëruar nga Vinci S.A., e cila është shoqëria mëmë kontrolluese, përfundimtare, e shoqërive të Grupit Vinci, duke përfshirë Vinci Energies.

Vinci Energies S.A. përfaqëson aktivitetet e Vinci Group në lidhje me energjinë dhe shërbimet e IT. Ajo është kryesisht aktive në fushat e teknologjive të komunikimit, energjisë dhe infrastrukturës së transportit, përmirësimin e performancës industriale, etj.

Vinci Group nuk ka asnjë degë dhe/ose filial të regjistruar në Shqipëri dhe gjatë vitit 2021 nuk ka gjeneruar xhiro në tregun shqiptar.

**Pala shitëse: Kontron AG.**, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Austriak. Shoqëria Kontron AG u shërben prodhuesve të pajisjeve origjinale, integruarve të sistemit dhe ofruesve të aplikacioneve të segmenteve të ndryshme të tregut (ndër të tjera: automatizimi industrial, komunikimi, transporti, energjia, avionika, mjekësia, info-argëtimi dhe ushtria). Kontron zhvillon, prodhon dhe shet produktet e saj në mbarë botën. Grupi i korporatës ka selinë në Augsburg dhe përbëhet nga Kontron Europe GmbH (Ismaning, Augsburg, Deggendorf dhe Saarbrücken), si dhe në San Diego, Fremont, Kaliforni, Montreal, Plzeň, Toulon, Bangalore, Taipei, Tokio dhe Pekin.

Me markën e saj S&T, kompania është një nga ofruesit kryesorë të shërbimeve të IT-së në Evropën Qendrore dhe Lindore që ofron një gamë të plotë shërbimesh IT, duke përfshirë operacionet e qendrës së të dhënave, menaxhimin e vendit të punës, sigurinë e IT ose konsulencën e IT.

#### **Shoqëritë Target:**

**Shoqëritë e Shërbimit IT** janë shoqëri të zotëruara direkt dhe indirekt: S&T Albania SHPK, Amanox Solution AG, S&T Serbia d.o.o Beograd, Hamcos IT Service GmbH, S&T Deutschland GmbH, S&T Mold ,Citycomp Service GmbH dhe S&T Cee Holding s.r.o.

- *S&T Albania SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Import-Eksport, tregtim i produkteve, licencave software, pajisjeve informatike, kompjuterike, elektronike si dhe sistemeve për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve, hardware dhe software, të rrjetave të komunikimit të të dhënave dhe të gjithë periferikëve të tyre, etj.

- *Amanox Solution AG*, është një shoqëri aksionare, e regjistruar në Kantonin Bern, Zvicër, me objekt të shoqërisë: ofrimin e shërbimeve të çdo lloji në sektorin e IT-së, prodhimin dhe tregtimin e harduer dhe softuer, etj.

- *S&T Serbia d.p.o.*, me seli në Beograd, është një kompani fokusi i së cilës është në shërbimet dhe zgjidhjet e IT, bazuar në teknologjinë botërore si dhe një portofol të gjerë produktesh inovative të prodhimit të saj..

- *Hamcos IT Service GmbH*, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Shërbime IT dhe Konsulencë IT, hardueri, softueri, zgjidhjet e ruajtjes, zgjidhjet rezervë, teknologjia e zyrës, teknologjia e prezantimit, zgjidhjet e rrjetit, sistemet telefonike, virtualizimi, serverët dhe zgjidhjet e Microsoft.

- *S&T Deutschland GmbH*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimi, prodhimi dhe shitja e pajisjeve elektronike, sistemeve dhe produkteve të të gjitha llojeve si dhe zhvillimi, prodhimi dhe shitja e produkteve harduerike dhe softuerike dhe ofrimi i shërbimeve.

- *S&T Mold*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Republikën e Moldavisë, me objekt aktiviteti: Punime për ndërtimin e ndërtesave për banim dhe jo për banim, ndërtimin e rrugëve dhe autostradave, etj, Tregtia me shumicë e kompjuterëve, e pajisjeve periferike dhe software-it, veprimtari të editimit të produkteve të tjera software, veprimtari të tjera të komunikimeve elektronike, etj.

- *Citycomp Service GmbH*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Mirëmbajtja, dhënia me qira dhe shitja e hardware dhe softwer IT, konsulencë në sistem, mbështetje dhe të gjitha transaksionet e lidhura.

- *S&T Cee Holding s.r.o*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit Sllovak, me objekt aktiviteti: Blerja e mallrave për shitje te konsumatori përfundimtar, për shitje tek tregtarë të tjerë, veprimtari konsulence në fushën e teknologjisë informatike, veprimtari financiare, ofrimi i softwerit-sigurimi i programe kompjuterike në bazë të kontratës me autorin, etj.

## **II. Përqendrimi**

Më datë 10.08.2022, është lidhur “Marrëveshje blerje aksionesh për shit-blerjen e shoqërive të Kontron IT Service”, ndërmjet shoqërisë Vinci Energies S.A.(blerësi) dhe shoqërisë Kontron AG (shitësi).

Shitësi është aksionar i drejtpërdrejte dhe i tërthortë i Shoqërive të Shërbimit IT.

Bazuar në ftesën për ofertë të publikuar më datë 17 mars 2022, shitësi ka filluar një proces shitjeje për aksionet e tij të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në shoqëritë e shërbimit IT.

Objekt i kësaj marrëveshje janë aksionet e parashikuara në aneksin 2.3 Pjesa A të marrëveshjes, me kushtin që, aksionet e S&T Moldavia do të jenë objekt i kësaj Marrëveshje vetën nëse nuk ndodh asnjë Ngjarje Përrjashtimi Moldavian; dhe me kusht që, në rast se S&T Moldavia nuk bëhet objekt i kësaj Marrëveshje, filiali i saj, në pronësi të plotë S&T IT i Moldavia, nuk do të jetë objekt i kësaj Marrëveshje as direkt dhe as drejtpërdrejt.

Referuar marrëveshjes së përfutimit të kontrollit të shoqërive të shërbimit IT të Kontron AG nga shoqëria Vinci Energies S.A si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **III. Analiza e Konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimeve të teknologjisë së informacionit (IT) dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Grupi Kontron AG do të shesë Shoqëritë e Shërbimit IT: Amanox Solution AG, S&T Serbia Predyzece za informaticki inzenjering i zastupanje d.o.o., Hamcos IT Service GmbH, S&T



Deutschland GmbH, S&T CITYCOMP, S&T Mold srl, S&T CEE Holding s.r.o. dhe S&T Albania SHPK tek shoqëria Vinci Energies S.A.

Në Shqipëri, transaksioni i njoftuar do të ketë për pasoje ndryshim e kontrollit të shoqërisë S&T Albania SHPK, e cila pas transaksionit do të kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shoqëria Vinci Energies S.A.

Shoqëria Vinci Energies S.A. dhe asnjë shoqëri e Vinci Group nuk kanë degë dhe/ose filial të regjistruar në Shqipëri dhe nuk kanë gjeneruar të ardhura.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,


### VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive të shërbimit IT të Kontron AG nga shoqëria Vinci Energies S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS


**Leida MATJA**

()  
Zv/Kryetar


**Rezana KONOMI**

()  
Anëtar

**Adriana BERBERI**

()  
Anëtar

**Durim KRAJA**

()  
Anëtar

**Denar BIBA**

()  
Kryetar